

AKT THEMELIMI
“GARDEN BOUTIQUE HOTEL” SH.P.K.

EMËRTIMI

Emërtimi i Shoqërisë është “GARDEN BOUTIQUE HOTEL” SH.P.K. me poshtë e quajtur “Shoqëria”.

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

SELIA

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Kavajes, Objekti Garden Building, Kati i trete.

Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

OBJEKTI

Objekti i Shoqërisë do të konsistojë në:

- Hoteleri turizëm.Sherbime mengjesi. Import-eksport të pajisjeve të ndryshme hotelerie, industriale, makineri e pajisje të ndryshme
- Bar Kafe
- Ushtrim i veprimtarisëse lire private ne fushen e turizmit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Shoqeria do te ushtroje cdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) Lekë i ndarë në 2 (dy) kuota.

Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga Ortakët e Shoqërisë:

- Alked Zyber Pasmaçiu, lindur me 10.09.1978 ne Ndroq, Tirane dhe me banim ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID Nr.Personal H90910044P date 01.04.2014, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar:
Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 60 (gjashtëdhjetë) Lekë që përben 60 (gjashtëdhjetë) % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Aishe Nevruz Pasmaçiu lindur me 03.03.1991 ne Peze e Madhe, Tirane dhe me banim ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID Nr.Personal J15303064D date 16.02.2018, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar:
Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40 (dyzetë) Lekë që përben 40 (dyzetë) % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në Statut.



Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me Statutut dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga Statuti, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

Asambleja mbledhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

Vendimet e zakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 30 % të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Vendimet merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 80 % të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme vendos për:

përcaktimin e politikave tregtare

ndryshimin e Statutit

emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre

emërimin dhe shkarkimin e likuidatori/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre

mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë

miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë

miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë

pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre

përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve

shpërndarjen e fitimeve

riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë

çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut

Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

Administrator i parë i Shoqërisë caktohet Z. Bledjan Zyber PASMAÇIU, lindur me 28.03.1982 ne Ndroq, Tirane dhe me banim ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoffim ID Nr.Personal I20328200E date 20.05.2019, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Llogaria bankare celet nga Administratori i Shoqërisë Z. Bledjan Zyber PASMAÇIU.

Administratori i parë i Shoqërisë Z. Bledjan Zyber PASMAÇIU, ka te drejte te realizoje cdo veprim ne llogarite e Shoqerise.


Dhe personi i pajisur me Autorizim (Prokure E Posacme) nga Ortaku i Vetem i Shoqërisë, ka te drejte te realizoje transferta, terheqje apo cdo lloj veprimi tjeter ne llogarite e Shoqerise.

Nënshkruar, sot më datë 10.10.2023

ORTAKET E SHOQËRISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"GARDEN BOUTIQUE HOTEL" SH.P.K.

Alked PASMACHI



Aishe PASMAÇIU

